

..

<u>KËRKESE</u>	<u>APPLICATION</u>
Drejtuar: GJYKATËS KUSHTETUESE	To: THE CONSTITUTIONAL COURT
KËRKUES: Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS), organizatë jofitimprurëse e regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3048, datë 28.03.2011, si dhe me seli në adresën: Rruga “Asim Vokshi”, Pallati 13/25, kati III, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive Aranita Brahaj kontakt aranita.brahaj@ais.al	APPLICANT: The Albanian Institute of Science (AIS), a non-profit organization registered with the decision of the Tirana Judicial District Court no. 3048, dated 28.03.2011, and with its seat located on Rruga “Asim Vokshi”, Pallati 13/25, floor III, Tirana, represented by its Executive Director, Aranita Brahaj, by contact aranita.brahaj@ais .al
SUBJEKTE TË INTERESUAR: Kuvendi i Shqipërisë, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4, Tiranë. Këshilli i Ministrave, më adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.	INTERESTED PARTIES: The Assembly of Albania, with its address on: Boulevard "Dëshmorët e Kombit", no. 4, Tirana. Council of Ministers, with its address on: Boulevard "Dëshmorët e Kombit", Tirana.
OBJEKTI: Shfuqizimi i Kreut VI, PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK, nenet 40 – 44, dhe neni 4, pika 7 dhe pika 9, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 97/2019, në datën 18.12.2019.	SCOPE: Repeal of Chapter VI, PUBLIC PROCUREMENT PROCEDURES, articles 40 - 44, and article 4, point 7 and point 9, of the normative act with the force of law no. 9, dated 16.12.2019 "On coping with the consequences of natural disasters", approved by the Assembly of Albania with law no. 97/2019, on 18.12.2019. Suspension of the implementation of Chapter VI, PUBLIC

Pezullimi i zbatimit të Kreut VI, PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK, nenet 40 – 44 të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 97/2019, në datën 18.12.2019.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 18, 116, 131, pika 1, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “h” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 45, pika 1, 47, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Të nderuar anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS) duke vlerësuar se disa nene të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 97/2019, në datën 18.12.2019, bien në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë paraqet para jush kërkesën me përmbajtjen si vijon.

Për legjitimimin e kërkesit

Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenin

PROCUREMENT PROCEDURES, articles 40 - 44 of the normative act with the force of law no. 9, dated 16.12.2019 "On coping with the consequences of natural disasters", approved by the Assembly of Albania with law no. 97/2019, on 18.12.2019.

LEGAL BASIS: Articles 11, 17, 18, 116, 131, point 1, letter "a", 134, point 1, letter "h" and 134, point 2, of the Constitution of the Republic of Albania; articles 27, 28, 45, point 1, 47, 49, 50 and 51 of law no. 8577, dated 10.02.2000 "On the organization and functioning of the Constitutional Court of the Republic of Albania", as amended.

Honorable members of the Constitutional Court,

The Albanian Institute of Science (AIS), having found that some articles of the normative act with the force of law no. 9, dated 16.12.2019 "On coping with the consequences of natural disasters", approved by the Assembly of Albania with law no. 97/2019, on 18.12.2019, are in conflict with the Constitution of the Republic of Albania, presents to you the following request:

As for the legal standing of the applicant

The applicant is legitimized *ratione personae*, based on Article 134, point 1, letter "h", of the Constitution and the

134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Kërkuesi është një shoqatë që ka si qëllim të punës, ndër të tjera të veprojë për Transparencë, Llogaridhënie dhe Mirëqeverisje duke zbatuar projekte dhe aktivitete që lidhen me monitorim, sensibilizim dhe advokim në shpërndarje të drejtë pa abuzim, klientelizëm dhe korrupsion të Parave dhe Kontratave Publike, veprime që lidhen me mbrojtjen e të drejtës për liri të veprimtarisë ekonomike, të drejtës për konkurrencës dhe barazi në garë, të drejta që sipas tij, në rastin konkret cenohen nga dispozitat e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 97/2019, në datën 18.12.2019, prandaj interesi për kundërshtimin e tyre është i justifikuar.

Për sa i përket legjitimitimit të shoqatave, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën, sipas nenit 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar legjitimitimin e këtyre subjekteve për çështje që lidhen me interesat e tyre. Dispozitat e kundërshtuara në objektin e kërkesës rregullojnë marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së kërkueses, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*vendimet nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 33, datë 08.06.2016; nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

jurisprudence of the Constitutional Court. The applicant is an organization, whose activity aims at ensuring Transparency, Accountability, and Good Governance by implementing projects and activities related to monitoring, awareness, and advocacy for fair distribution of Public Money and Contracts free from abuse, clientelism, and corruption, acts related to the protection of the right to freedom of economic activity, the right to competition and equality in competition, rights that according to the applicant are affected in this case by the provisions of the normative act with the force of law no. 9, dated 16.12.2019 "On coping with the consequences of natural disasters", approved by the Assembly of Albania with law no. 97/2019, dated 18.12.2019, therefore its interest in challenging such act is justified.

Regarding the legal standing of organizations, as entities that put the Court in motion, according to Article 134, point 1, letter "h" of the Constitution, the Court already has a consolidated jurisprudence, which has accepted the legal standing of these entities for cases that relate to their interests. The disputed provisions in the object of this request regulate relations that are included in the purpose of the activity of the applicant, according to the definitions made in the Constitution, in the laws or, in the case of the subjects of private law, in the statute (*decision no. 4, dated 15.02.2021, No. 1, dated 16.01.2017; No. 33, dated 08.06.2016; and No. 14, dated 21.03.2014 of the Constitutional Court*).

AIS është regjistruar si person juridik - organizatë jofitimprurëse - me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3048, datë 28.03.2011.

Organizata është duke zbatuar Projekte që lidhen me Shpenzime, Prokurimet , Kontraktimet Publike, Cështje të Mirëqeverisjes dhe të Antikorrupsionit, disa prej tyre si vijon:

- OpenData, Akses dhe Transparencë për Sektorë të ekspozuar dhe me risk për Korrupsion.
- OpenContractingAlbania Risk Assesment & RedFlag
- Kontrata Publike në gjendje të Katastrofave Natyrore, Forcimi i Mekanizmave të Pavarur të Monitorimit

AIS ka krijuar sisteme databazë të monitorimit të Tenderimit dhe Kontraktim si Open Procurement Albania <http://openprocurement.al/> ,

sistem monitorimi për kontraktime Programi Shtetëror i Rindërtimit <http://openprocurement.al/sq/tender/rindertimi>

Sistem për vlersim risku (automatikisht) në tenderim <http://openprocurement.al/sq/index/redflag>

DataBaza për monitorim të Shpenzimeve Publike dhe Integritetit të të Zgjedhurve dhe Emruarve të Lartë Publik <http://spending.data.al/>

Sipas vendimit të gjykatës dhe përmbajtjes së statutit është një organizatë jofitimprurëse që ka si mision ndër të tjera

AIS is registered as a legal entity - non-profitable organization - by decision of the Tirana Judicial District Court no. 3048, dated 28.03.2011.

The organization is implementing Projects related to Expenditures, Procurement, Public Contracting, Good Governance, and Anti-Corruption Issues, some of which are as follows:

- OpenData, Access and Transparency for sectors exposed to risk of corruption.
- OpenContractingAlbania Risk Assesment & RedFlag
- Public Contracts in States of Natural Disasters, Strengthening Independent Monitoring Mechanisms

AIS has established database systems for monitoring Tendering and Contracting, such as Open Procurement Albania <http://openprocurement.al/> ,

contract monitoring system for the State Reconstruction Program <http://openprocurement.al/en/tender/rindertimi>

(automatic) Risk assessment system for tendering <http://openprocurement.al/en/index/redflag>

Database for monitoring Public Expenditure and Integrity of Elected and Senior Public Appointed Officials <http://spending.data.al/>

According to the court decision and the content of its statute, AIS is a non-profit organization, whose mission

edhe:

- Promovim dhe inicim i iniciativave ligjore apo qytetare me qëllim njohjen, garantimin dhe respektimin e të drejtave të individëve dhe grupeve sociale.
- Sensibilizim mbi tema që lidhe me çështje të sigurisë, qeverisjes dhe bashkëjetesës sipas parimeve dhe kriterëve të vendosura nga legjislacioni kombëtar e legjislacioni evropian.

Për rastin në shqyrtim, kërkuesi parashtrohet para Gjykatës argumente në lidhje me cenimin që dispozitat e aktit normativ me fuqinë e ligjit, i miratuar nga Kuvendi - objekt i këtij kontrolli kushtetues - i bëjnë të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, të cilat kjo organizatë ka për mision që t'i mbrojë. Për pasojë kërkuesi provon interesin e tij për ta vënë në lëvizje Gjykatën, prandaj legjitimohet *ratione personae* për të iniciuar kontrollin kushtetues të aktit normativ me fuqinë e ligjit objekt shqyrtimi.

Cënimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike, parashikuar në nenin 11 të Kushtetutës, në raport me nenin 17 dhe 18 të Kushtetutës

Neni 11 i Kushtetutës garanton se:

“1. Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe

includes, among others:

- Promotion and initiation of legal or civic initiatives in order to recognize, guarantee and respect the rights of individuals and social groups.
- Awareness on topics related to security, governance, and coexistence issues according to the principles and criteria established by national legislation and European legislation.

In the present case, the applicant submits to the Court arguments regarding the violation found in the provisions of the normative act with the force of a law, adopted by the Assembly - subject to this constitutional review - against the fundamental rights and freedoms provided in the Constitution, which this the organization has a mission to protect them. Consequently, the applicant proves its interest in setting the Court in motion, therefore the applicant has the legal standing as *ratione personae* to initiate the constitutional review of the normative act with the force of law under review.

Violation of the freedom of economic activity, provided in Article 11 of the Constitution, in relation to Articles 17 and 18 of the Constitution

Article 11 of the Constitution guarantees that:

“1. The economic system of the Republic of Albania is

në lirinë e veprimtarisë ekonomike.
2. Prona private dhe publike mbrohen njëllë me ligj.
3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.”

Neni 18 i Kushtetutës sanksionon se:

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Gjykata Kushtetuese ka elaboruar konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës. Sipas saj, kjo liri nënkupton kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve. Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës, lirinë e qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave pa asnjë kufizim dhe,

based on private and public property, as well as on the market economy and the freedom of economic activity.
2. Private and public property are equally protected by law.
3. Restrictions on the freedom of economic activity may be imposed only by law and only for important public reasons.”

Article 18 of the Constitution stipulates that:

1. All are equal before the law.
2. No one shall be subjected to arbitrary interference with his privacy, family, home, or correspondence, nor to attacks upon his honor and reputation.
3. No one shall be discriminated against for the reasons set out in paragraph 2 unless there is a reasonable and objective justification.

The Constitutional Court has elaborated the concept of freedom of economic activity guaranteed by Article 11 of the Constitution. According to the Constitutional Court, this freedom mainly means the right to enter into contracts, individually or collectively, freely and on the basis of personal will, the right to choose the activity that the individual wants to exercise, the right to choose a job according to preference, etc. This freedom includes all rights relating to the production, distribution, or consumption of goods and services. The highest form of economic freedom means the right to property, the freedom

se individi ka të drejtë të punojë, të prodhojë, të konsumojë dhe të investojë në çdo mënyrë që i pëlqen dhe kjo liri duhet të mbrohet nga shteti.

Liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete shumë të drejta dhe liri si: liria e biznesit ose aftësia për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, liria e tregtisë ose mungesa e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, liria monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, liria fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende të lirë nga ndërhyrja e shtetit, liria e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, liria financiare dhe pavarësia nga kontrolli shtetëror, liria e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti. (*vendimi nr. 12, datë 28.4.2009 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr. 10, datë 19.03.2008, i Gjykatës Kushtetuese.*)

Gjykata Kushtetuese është shprehur se liria e veprimtarisë ekonomike përmban edhe detyrimin e shtetit që, nëpërmjet Ligjvënësit, të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i të mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara. Vetëm

of movement of labor force, capital, and goods without any restrictions, and that the individual has the right to work, to produce, to consume, and to invest in every way that he likes and this freedom must be protected by the state.

Freedom of economic activity contains in itself many rights and freedoms such as: freedom of business or the ability to set up and close a business, freedom of trade or the absence of barriers related to the import and export of goods and services, monetary freedom as a measure for guaranteed price stability, fiscal freedom on income whether individual or business, in particular, property rights as the ability of individuals to collect, possess and dispose of items free from state interference, freedom of investment and circulation freedom of capital, especially foreign capital, financial freedom and independence from state control, freedom of labor to interact without restrictions by the state. (*Decision No. 12, dated 28.4.2009 of the Constitutional Court and Decision No. 10, dated 19.03.2008, of the Constitutional Court.*)

The Constitutional Court has stated that the freedom of economic activity also contains the obligation of the state to, through the Legislator, intervene in the regulation of this freedom, in order to guarantee, in addition to the freedom of economic activity, the principle of the social state and the common good. This obligation for regulation of the legislator is expressed through the issuance of concrete legal norms, by which the aim is to discipline the exercise

shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i mbart me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike (*vendimi nr. 12, datë 28.4.2009 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr.10, datë 19.03.2008 i Gjykatës Kushtetuese.*)

Gjykata Kushtetuese më tej ka sqaruar kriteret në bazë të të cilave shteti mund të ndërhyjë për të rregulluar ushtrimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike sipas Kushtetutës. Ajo është shprehur, se nisur nga struktura e Kushtetutës, e veçanta e nenit 11, paragrafi 3, është se ai nuk është parashikuar në grupin e të drejtave dhe lirive të tjera, por në pjesën ku parashikohen parimet themelore mbi të cilat mbështetet organizimi dhe funksionimi i shtetit. Kushtetutbërësi ka preferuar ta konsiderojë lirinë e veprimtarisë ekonomike së pari, si parim bazë të sistemit ekonomik të Republikës së Shqipërisë.

Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar cenimin ose jo të lirisë ekonomike duke iu referuar edhe përmbajtjes së nenit 17/1 të Kushtetutës, e cila shtrihet ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive të parashikuara në të, sipas të cilit, "*kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë*". Kjo dispozitë, përveç arsyes publike, përmban detyrimin për të

of free economic activity in certain sectors or areas. Only the state can manage to create the real and optimal environment for the exercise of this personal freedom, therefore it should be seen as a regulator in order to protect the market from distortions that may naturally come with the free development of economic activity (*decision no. 12, dated 28.4.2009 of the Constitutional Court and decision no. 10, dated 19.03.2008 of the Constitutional Court.*)

The Constitutional Court has further clarified the criteria according to which the state can intervene to regulate the exercise of freedom of economic activity according to the Constitution. The Court noted that based on the structure of the Constitution, what is special about Article 11, paragraph 3, is that it is not provided in the group of other rights and freedoms, but in the part where the basic principles on which the organization and functioning of the state are based. The Constitution has opted to consider the freedom of economic activity first, as a basic principle of the economic system of the Republic of Albania.

The Constitutional Court has considered whether there has been a violation of economic freedom, referring to the content of Article 17/1 of the Constitution, which applies to all rights and freedoms provided in it, according to which, "*restrictions on rights and freedoms provided for in this Constitution may be established only by law, in the public interest or for the protection of the rights of others. The restriction must be in proportion to the situation that has*

respektuar edhe kriteret tjetra, si: kufizimi për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë. Parimi i njohur i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësist për kufizimin e një të drejte apo lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet.

Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet jurisprudencës së saj, në disa vendime ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Konkretisht, ajo është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë, ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.*

Për shkak të rolit aktiv të shtetit në drejtim të ushtrimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike, kushtetutëbërësi në nenin 11, paragrafi 3, të Kushtetutës ka parashikuar kriteret mbi bazën e të cilave mund të ndërhyhet për të rregulluar ushtrimin e kësaj të drejte, duke përcaktuar se, *“kufizime të*

dictated it.” This provision, in addition to public reason, contains the obligation to respect other criteria, such as the restriction on the protection of the rights of others and the existence of a fair relationship between the restriction and the situation that dictates it. The well-known principle of proportionality means that the intervention of the legislator for the restriction of a certain right or freedom is done with appropriate means that respond to the goal that is intended to be achieved.

The Constitutional Court, through its jurisprudence, in some decisions has interpreted Article 18 of the Constitution and has emphasized that the principle of equality aims for all to be equal before the law, not only in the fundamental rights provided in the Constitution but also in other legal rights. Specifically, the Court stated that: *“Equality by law and before the law does not mean that there are equal solutions for individuals or categories of persons who are in objectively different conditions. Equality before the law and by law presupposes the equality of individuals who are on equal terms”, as well as “Only in exceptional cases and for reasonable and objective reasons may differentiated treatment of certain categories that benefit from this right be justified.*

Due to the active role of the state in regard to the exercise of freedom of economic activity, the author of the constitution provides in article 11, paragraph 3, of the Constitution the criteria on the basis of which interventions

lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike". Kushtetutëbërësi ka preferuar ta konsiderojë lirinë e veprimtarisë ekonomike, së pari, si parim bazë të sistemit ekonomik të Republikës së Shqipërisë dhe, së dyti, si pjesë e katalogut të lirive dhe të të drejtave të shtetasve. Është pikërisht ky element dallues i kësaj lirie, pra qenia e saj si një nga shtyllat e shtetit demokratik, që i jep asaj një natyrë të veçantë. Kjo veçanti shprehet edhe në aspektin e parashikimit të kriterit kufizues në të njëjtën dispozitë që duhet të aplikohet në raste konkrete (*shih vendimin nr. 89, datë 28.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Kushtetuese i drejtohet edhe përmbajtjes së nenit 17, pika 1, të Kushtetutës, që shtrihet ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive të parashikuara në të. Konkretisht, kjo dispozitë parashikon se *"kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë."* Pra, kjo dispozitë, përveç arsyes publike, të cilën e gjejmë edhe te neni 11, pika 3, përmban detyrimin për të respektuar edhe kriteret e tjera, si kufizimi me anë të ligjit dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë (*vendimi nr. 89, datë 28.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

Nën dritën e kërkesave të nenit 11 dhe 18 të Kushtetutës, veçanërisht kur bëhet fjalë për prokurimin

can be made to regulate the exercise of this right, stipulating that *"Restrictions on the freedom of economic activity may be imposed only by law and only for important public reasons."* The Constitution has opted to consider the freedom of economic activity, firstly, as a basic principle of the economic system of the Republic of Albania and, secondly, as part of the catalog of freedoms and rights of citizens. It is precisely this distinctive element of this freedom, that is, it's being as one of the pillars of the democratic state, that gives it a special nature. This particularity is also expressed in terms of the provision of the restrictive criterion in the same provision that must be applied in concrete cases (*see decision no. 89, dated 28.12.2017 of the Constitutional Court*).

The Constitutional Court also addresses the content of Article 17, point 1, of the Constitution, which applies to all the rights and freedoms provided in it. Specifically, this provision stipulates that *"restrictions on the rights and freedoms provided for in this Constitution may be imposed only by law, in the public interest or for the protection of the rights of others. The restriction must be in proportion to the situation that has dictated it."* Thus, this provision, in addition to the public reason, which we find in Article 11, point 3, contains the obligation to respect other criteria, such as limitation by law and the existence of a fair relationship between the restriction and the situation that dictates that (*decision no. 89, dated 28.12.2017 of the Constitutional Court*).

e mallrave apo shërbimeve me fonde publike, nevoja e mbrojtjes së interesit publik është më e lartë.

Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED) është shprehur se nëse një masë e ndërmarrë nga shteti passjell pabarazi mundësisht midis operatorëve ekonomikë dhe, për rrjedhojë, shtrembëron konkurrencën, atëherë një masë e tillë përbën një shkelje të ligjit të BE-së për konkurrencën (C-462/99, *Connect Austria Gesellschaft für Telekommunikation GmbH kundër Telekom-Control-Kommission*, 22 maj 2003, § 84). Edhe kur objekt i shqyrtimit kanë qenë prokurimet publike, GJED-ja ka arritur në përfundimin se sipas parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, qëllimi i të cilit është të promovojë zhvillimin e një konkurrence të shëndetshme dhe efektive midis operatorëve që marrin pjesë në një procedurë prokurimi publik, këtyre të fundit duhet t'u jepen mundësi të barabarta në formulimin e ofertave të tyre, çka nënkupton që operatorët duhet t'i nënshtrohen të njëjtave kushteve.

Për më tepër, parimi i trajtimit të barabartë do të thotë që ofertuesit duhet të jenë në gjendje të barabartë, si gjatë fazës së përgatitjes së prokurimeve të tyre, ashtu edhe kur ofertat vlerësohen nga autoriteti kontraktues. Në rastin kur një person merr pjesë në realizimin e një kontrate publike, në mënyrë që ndikon në kushtet e kontratës dhe favorizohet prej saj, një situatë e tillë shtrembëron konkurrencën midis operatorëve ekonomikë dhe bie në kundërshtim me trajtimin e barabartë të tyre. Në të gjitha procedurat e

In light of the requirements of Articles 11 and 18 of the Constitution, especially when it comes to the procurement of goods or services with public funds, the need to protect the public interest is higher.

The European Court of Justice (ECJ) has ruled that if a measure taken by the State entails inequality of opportunity between economic operators and, as a result, distorts competition, then such a measure constitutes a breach of EU competition law (C- 462/99, *Connect Austria Gesellschaft für Telekommunikation GmbH v. Telekom-Control-Kommission*, 22 May 2003, § 84). Even when public procurement has been the subject of review, the ECJ has concluded that according to the principle of equal treatment of economic operators, the purpose of which is to promote the development of healthy and effective competition between operators participating in a public procurement procedure, the latter should be given equal opportunities in formulating their bids, which means that operators should be subject to the same conditions.

Furthermore, the principle of equal treatment means that bidders must be on an equal footing, both during the stage of preparing their procurements and when bids are evaluated by the contracting authority. In case a person participates in the execution of a public contract, in a way that affects the terms of the contract and is favored by it, such a situation distorts the competition between economic

prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë dhe verifikojë nëse ekzistojnë rreziqe reale që mund të ndodhë diçka që do të shtrembëronte konkurrencën (T-292/15, *Vakakis kai Synergates — Symvouloi gia Agrotiki Anaptixi AE Meleton kundër European Commission*, 12 shkurt 2019, §§ 97 dhe 100).

Në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese liria e veprimtarisë ekonomike në një ekonomi tregu të shëndoshë është e lidhur ngushtë me konkurrencën. Një sistem efikas ekonomik duhet të evidentojë dhe t'i hapë rrugë promovimit të konkurrencës së lirë të operatorëve të tij, me qëllim që të maksimalizojë mirëqenien ekonomike-sociale. (Vendimi nr. 29, datë 02.07.2021)

Me Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Këshilli i Ministrave ka miratuar rregullat për funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse. Objekti i këtij Akti Normativ është përballimi i pasojave të fatkeqësive natyrore që ndodhin në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të fatkeqësive të tjera që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të

operators and is contrary to their equal treatment. In all procurement procedures, the contracting authority must determine and verify whether there are real risks that something could distort competition (T- 292/15, *Vakakis kai Synergates - Symvouloi gia Agrotiki Anaptixi AE Meleton v European Commission*, 12 February 2019, §§ 97 and 100).

In the Constitutional Court's assessment, freedom of economic activity in a sound market economy is closely linked to the competition. An efficient economic system must identify and pave the way for the promotion of free competition of its operators, in order to maximize socio-economic well-being. (Decision no. 29, dated 02.07.2021)

With the Normative Act no. 9, dated 16.12.2019 "On coping with the consequences of natural disasters", the Council of Ministers has approved the rules for the functioning of bodies responsible for the rehabilitation and reconstruction of communities and territories affected by natural or other disasters, as well as the development of new territories, defining their duties and responsibilities, reconstruction process programs, the functioning of the reconstruction fund and relevant procedures. The object of this Normative Act is to deal with the consequences of natural disasters that occur in part or in the entire territory

mbrojtjes civile dhe të autoriteteve të tjera shtetërore dhe për të cilat shpallet gjendja e fatkeqësisë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile.

Akti Normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, është miratuar në datën 17.12.2019 me ligjin nr. 97/2019. Gjithashtu, ky Akt Normativ ka përcaktuar edhe procedurat e prokurimit që do të zbatohen në rastet e përballimit të pasojave të fatkeqësive natyrore.

Më konkretisht, në nenin 4 “Përkufizimet”, pika 9 të aktit normativ përcaktohet se:

“Prokurimi publik për rindërtimin”, është procesi i përshpejtuar i prokurimit që zbatojnë autoritetet kontraktore për përzgjedhjen e fituesve për kontratat publike për mallra, punë dhe shërbime, në kuadër të zbatimit të procesit të rindërtimit, në përputhje me parashikimet e këtij akti dhe të ligjit për prokurimin publik, për aq sa nuk bie në kundërshtim me parashikimet e këtij akti”.

Neni 40 “Objekti” pika 1 parashikon:

“1. Objekt i këtij kreu është përcaktimi i rregullave të posaçme që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga njësitë zbatuese në funksion të procesit të rindërtimit, përveç rasteve kur në këtë akt parashikohet ndryshe.”

of the Republic of Albania, as well as other disasters that, due to their intensity, scale and extent, require immediate intervention of all civil protection institutions and other state authorities and for which the state of disaster is declared in accordance with the provisions of the legislation in force on civil protection.

The Normative Act with the force of law no. 9, dated 16.12.2019 "On coping with the consequences of natural disasters", was approved on 17.12.2019 with law no. 97/2019. Also, this Normative Act has defined the procurement procedures that will be applied in cases of coping with the consequences of natural disasters.

More specifically, Article 4 "Definitions", point 9 of the normative act stipulates that:

"Public Procurement for Reconstruction", is the accelerated procurement process implemented by the contracting authorities for the selection of winners for public contracts for goods, works, and services, in the framework of the implementation of the reconstruction process, in accordance with the provisions of this act and the law for public procurement, insofar as it does not contradict the provisions of this act”.

Article 40 "Scope" point 1 provides:

“1. The scope of this chapter is to determine the special rules that apply to the procurement of goods, works, and

Neni 41, pika 1 “Parimet e prokurimit publik për rindërtimin” përcakton:

“1. Prokurimi publik për rindërtimin siguron:

a) mirëpërdorimin e fondit të rindërtimit dhe uljen e shpenzimeve procedurale;

b) nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë;

c) trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë;

ç) integritetin, besimin publik dhe transparencën.”

Ndërsa neni 41, pika 3 parashikon se:

“Përzgjedhja e fituesve, që zbatojnë kontratat publike në kuadër të procesit të rindërtimit, kryhet sipas kritereve të vlerësimit në lidhje me objektin e kontratës që prokurohet dhe janë cilësia, çmimi dhe koha e zbatimit të kontratës.”

Ndërsa neni 42 pika 6 parashikon se:

“6. Njësia zbatuese përdor procedurën e përshpejtuar, sipas përcaktimeve të këtij akti, për përzgjedhjen e fituesve të marrëveshjes kuadër për procesin e rindërtimit. Në çdo rast, konkurrimi për marrëveshjen kuadër bëhet me detyrimin për paraqitjen e kapaciteteve teknike, ligjore, ekonomike me ose pa detyrimin për paraqitjen e ofertës financiare.”

Po në nenin 42, pika 8, 9 dhe 10 përcaktojnë afatet e procedurës së përshpejtuar të prokurimit dhe afatet e ankimit, si më poshtë:

“8. Dokumentacioni dorëzohet në sistemin e prokurimeve

services by the implementing units in the function of the reconstruction process unless otherwise provided in this act. ”

Article 41, point 1 "Principles of public procurement for reconstruction" defines:

“1. Public procurement for reconstruction provides:

a) good use of the reconstruction fund and reduction of procedural costs;

b) promoting the participation of economic operators;

c) equal and non-discriminatory treatment for all economic operators;

ç) integrity, public trust and transparency.”

Whereas Article 41, point 3 provides that:

"The selection of winners, who implement public contracts within the reconstruction process, is done according to the evaluation criteria in relation to the object of the contract to be procured and include quality, price and time of implementation of the contract."

Whereas article 42 point 6 provides that:

“6. The implementing unit uses the accelerated procedure, according to the provisions of this act, for the selection of the winners of the framework agreement for the reconstruction process. In any case, the competition for the framework agreement is made with the obligation to submit technical, legal, economic capacities with or without the obligation to submit a financial bid.”

elektronike. Afati kohor për pranimin e dokumentacionit është 10 ditë kalendarike nga data e publikimit të njoftimit.

9. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit operatorët ekonomikë ankohen brenda 2 ditëve nga publikimi i dokumenteve të tenderit në Komisionin e Prokurimit Publik (KPP), që shqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe këtij akti. Me kalimin e këtij afati, nëse KPP-ja nuk është shprehur me vendim, autoriteti kontraktor vijon procedurën e prokurimit.

10. Pas afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, siç përcaktohet në njoftimin e kontratës, autoriteti kontraktor përzgjedh kandidatët brenda 10 ditëve kalendarike. Kundër vendimit të autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve paraqitet ankim administrativ pranë KPP-së, brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve fitues. KPP-ja shqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankesës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe të këtij akti. Për efekt kohe, komunikimi midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor bëhet nëpërmjet e-mail-it zyrtar. Me kalimin e këtij afati, nëse KPP-ja nuk është shprehur me vendim, autoriteti kontraktor vijon me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.”

Me VKM nr. 199 datë 04.03.2020 Këshilli i Ministrave ka miratuar dokumentat standarte të tenderit Tip, ku në pikën 4.1 të tyre përcaktohet se Lloji i Procedurës së Prokurimit

Also in article 42, points 8, 9 and 10 define the deadlines of the accelerated procurement procedure and the deadlines of the appeal, as follows:

“8. The documentation is submitted to the electronic procurement system. The deadline for receipt of documentation is 10 calendar days from the date of publication of the notice.

9. In the case of complaints about tender documents, economic operators complain within 2 days from the publication of tender documents to the Public Procurement Commission (PPC), which reviews the complaint and makes a decision within 3 days from the date of filing the complaint in accordance with the provisions of the Code of Administrative Procedures and this act. After this deadline, if the PPC has not expressed itself through a decision, the contracting authority follows the procurement procedure.

10. After the deadline for submission of requests to participate, as defined in the contract notice, the contracting authority selects the candidates within 10 calendar days. Against the decision of the contracting authority for the selection of candidates, an administrative appeal may be submitted to the CPC, within 3 days from the notification of the winning candidates. The CPC reviews the complaint and makes a decision within 5 days from the date of filing the complaint, in accordance with the provisions of the Code of Administrative Procedures and this act. For time efficiency, communication between the Public Procurement Commission and the contracting authority is done through official e-mail. After this

do të jetë Tender i Kufizuar në kuadër të Procesit të rindërtimit.

Duke marrë në analizë parashikimet e mësipërme lidhur me procedurën e posaçme të prokurimit të përcaktuar në Aktin Normativ nr. 9, në raport me parashikimet e Ligjit të Prokurimit Publik, si ligjin nr. 9643, i cili ishte në fuqi në kohën e miratimit të Aktit Normativ ashtu edhe Ligji nr. 162/2020 i cili është në fuqi që prej datës 31.03.2021, rezulton se:

KONSTATIM E	AKTI NORMATIV nr. 9	LIGJI nr. 9643/2006	LIGJI nr. 162/2020
Ligji i Prokurimit Publik është një ligj organik që normon të gjitha prokurimet publike për mallra shërbime apo punë	Neni 40 parashikon përcaktimin e rregullave të posaçme që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve.	Neni 1. Objekti dhe qëllimi parashikon përcaktimin e rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të	Neni 1. Objekti përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit.

deadline, if the PPC has not expressed itself through a decision, the contracting authority continues with the further steps of the procurement procedure. "

With DCM no. 199 dated 04.03.2020 the Council of Ministers has approved the standard documents of the Tender tender, wherein their point 4.1 it is determined that the Type of Procurement Procedure will be a Limited Tender within the Reconstruction Process.

